




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 5, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nenit 17, shkronja h) të Ligjit NR. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2013 për Numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, si dhe në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHT:

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA) SHPALL

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZEVE DHE TË SHKOLLAVE PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2016/2017

Nr.	Shkolla	Nr.i paral.	Nr. i nx.	Lëmia dhe profili	Gjithsej
1.	Gjimnazi "Sami Frashëri"	10	32	Gjimnaz i shkencave natyrore	320
	<i>Mësimi në gjuhën turke</i>	1	32	Gjim. i shk. natyrore/në gj.turke/	32
	Gjithsej	11	32		352
2.	Gjimnazi "Sami Frashëri II"	15	32	Gjimnaz i shkencave shoqërore dhe gjuhësore	352
	Gjithsej	15	32		480
3.	Gjimnazi "Xhevdet Doda"	12	32	Gjimnaz i shkencave natyrore	384
	Gjithsej	12	32		384
4.	Gjimnazi "Eqrem Çabej"	9	32	Gjimnaz filologjik	288
	Gjithsej	9	32		288

5.	Gjimnazi i Specializuar Matematikor	3	25	Gjimnazi matematikor	75
	Gjithsej	3	25		75
6.	SHMM "Dr.Ali Sokoli"	2	32	Teknik të farmacisë	64
		1	32	Teknik të dhëmbëve	32
		2	32	Infermier i përgjithshëm	64
		2	32	Teknik i fizioterapisë	64
	<i>Mësimi në gjuhën boshnjake</i>	1	32	Teknik të farmacisë - gjuhë boshnjake	32
	Gjithsej	8	32		256
7.	SHMT "28 Nëntori"	4	32	Ndërtimtari	128
		4	32	Arkitekturë	128
		2	32	Gjeodezi	64
		2	32	PTT	64
		3	32	Libër lidhje, grafikë shtypi, dizajn grafikë	96
	Gjithsej	15	32		480
8.	SHMEJ "Hoxhë K.Prishtina"	2	32	Ekonomik: Kontabilitet	64
		2	32	Ekonomik: Banka e sigurime	64
		2	32	Administratë: Asistent juridik	64
		3	32	Administratë: Asistent i administratës	96
		1	32	Ekonomik: Shpediton-logjistikë	32
		2	32	Administrim biznesi: Financa	64
		1	32	Administrim biznesi: Marketing	32
		1	32	Administrim zyre	32
	Gjithsej	14	32		448
9.	SHMHT "7 Shtatori"	1	32	Turizëm: Asistent i turizmit	32
		1	32	Hotelieri: Asistent i restorantit	32

		1	32	Hotelieri: Gjellbërës	32
		1	32	Tregti me pakicë-shumicë	32
	Gjithsej	5	32		160
10.	SHMAT "Abdyl Frashëri"	1	32	Bujqësi: Hortikulturë	32
		1	32	Bujqësi: Mbrojtja e bimëve	32
		2	32	Bujqësi: Agrobiznes	64
		1	32	Teknologjia e prodhimtarisë bujqësore	32
		2	32	Teknologjia ushqimore	64
		1	32	Veterinë: Veterinari	32
	Gjithsej	8	32		256
11.	SHME "Gjin Gazulli"	3	32	Teknik i informatikës	96
		2	32	Teknik i telekomunikacionit	64
		1	32	Energjetikë	32
		1	32	Instalim elektrik	32
		1	32	Elektroteknikë konsumuese dhe pajisjeve të zyreve	32
		1	32	Elektroteknikë industriale	32
	Gjithsej	9	32		288
12.	Medreseja "Alauddin"	3	32	Djem	96
		2	32	Vajza	64
	Gjithsej	5	32		160
13.	SHMM "Prenk Jakova"	1	32	Interpret	32
		1	32	Bashkëpunëtor muzikor	32
	Gjithsej	2	32		64
	Total	113	32		3616

Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2016/17, mund të konkurrojnë vetëm nxënësit të cilët kanë përfunduar shkollimin e mesëm të ultë në Komunën e Prishtinës (përfundimisht në Gjimnazin e specializuar matematikor dhe në ato drejtime në shkollat profesionale të cilat janë mungesë në komunat tjera), të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

Kriteret e detajuara për secilin drejtim i gjeni të publikuara në shkollat përkatëse dhe në ueb faqen e Komunës së Prishtinës.

Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2016/2017, bëhet më datën 14, 15 dhe 16 qershor 2016 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 17.06.2016.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 20.06.2016.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kritere:

- | | |
|---|----------------------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (25%) 25 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare në test | (15%) 15 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (60%) 60 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë **100** pikë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 25 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\frac{\text{Suksesi}(kl.6 + kl.7 + kl.8 + kl.9)}{4} \times 5 = 25$$

2. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 15 pikë (p.sh 3 lëndë të profilit të caktuar shumëzohet më mesataren e notave të kl. 6 – 9 të $(5+5+5+5) = 20$; $20 : 4 = 5$)

$$\frac{\text{mesatarja e lëndës (I)} + \text{mesatarja e lëndës (II)} + \text{mesatarja e lëndës (III)}}{3} \times 3 = 15 \text{ pikë}$$

Kur në profilin e caktuar kërkohen vetëm dy lëndë atëherë: $2 \times 5 = 10$ në këtë rast vlera e fituar shumëzohet me 1.5.

$$\frac{\text{mesatarja e lëndës (I)} + \text{mesatarja e lëndës (II)}}{2} \times 3 = 15 \text{ pikë}$$

3. Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

- **Gjimnazi i përgjithshëm** - Mesatarja e lëndëve: gjuhë amtare dhe matematikë së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve te testit (40 pikë)
- **Gjimnazi i gjuhëve** - Mesatarja e lëndëve: gjuhë amtare dhe gjuhë angleze, së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët gjuhë amtare dhe gjuhë angleze)
- **Gjimnazi i shkencave natyrore** - Mesatarja e lëndëve: fizikë, kimi, biologji së paku duhet të jetë 4 (katër), ky kriter vlen edhe për të gjitha profilet e shkollës së mjekësisë. si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji)
- **Gjimnazi i shkencave shoqërore** - Mesatarja e lëndëve: histori, gjeografi, edukatë qytetare së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët histori dhe gjeografi)
- **Gjimnazi matematikë - informatikë** - Mesatarja e lëndëve: matematikë, teknologji informative së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lënda e matematikës)

p.sh për tri lëndë: $\frac{\text{Kimi (3)} + \text{Biologji (4)} + \text{Fizikë (5)}}{3} = \frac{3+4+5}{3} = \frac{12}{3} = 4$

për dy lëndë: $\frac{\text{Matematikë (3)} + \text{T.Informative (5)}}{2} = \frac{3+5}{2} = \frac{8}{2} = 4$

B. Përmbajtja e testit – numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve:

I. Gjimnazi i gjuhëve

1. Gjuhë shqipe 20 pikë
2. Gjuhë angleze 5 pikë (Gjithsej 25 pikë)

II. Shkencat shoqërore:

1. Gjeografi 12 pikë
 2. Histori 13 pikë
- (Gjithsej 25 pikë)

III. Matematikë

1. Matematikë 20 pikë
 2. informatikë 5 pikë
- (Gjithsej 25 pikë)

IV. Shkencat natyrore:

1. Fizikë 9 pikë
2. Kimi 8 pikë
3. Biologji 8 pikë (Gjithsej 25 pikë)

4. Renditja e lëndëve me prioritet sipas drejtimeve të gjimnazeve:

I. Gjimnazi i përgjithshëm:

1. Të gjitha pikët e fituara nga testi. $100 \times 0.6 = 60$ pikë
- Totali = 60 pikë**

II. Gjimnazi matematikë- informatikë:

1. Matematikë dhe informatikë 25 $25 \times 1.2 = 30$ pikë
2. Shkencat natyrore 25 $25 \times 0.6 = 15$ pikë
3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 $25 \times 0.4 = 10$ pikë
4. Shkencat shoqërore 25 $25 \times 0.2 = 5$ pikë

Totali = 60 pikë

III. Gjimnazi shkencat e natyrës:

1. Shkencat e natyrës 25 $25 \times 1.2 = 30$ pikë
2. Matematikë dhe Informatikë 25 $25 \times 0.6 = 15$ pikë
3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 $25 \times 0.4 = 10$ pikë
4. Shkencat shoqërore 25 $25 \times 0.2 = 5$ pikë

Totali = 60 pikë

IV. Gjimnazi i gjuhëve:

1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 $25 \times 1.2 = 30$ pikë
2. Shkenca shoqërore 25 $25 \times 0.6 = 15$ pikë
3. Matematikë dhe Informatikë 25 $25 \times 0.4 = 10$ pikë
4. Shkenca natyrore 25 $25 \times 0.2 = 5$ pikë

Totali = 60 pikë

V. Gjimnazi shoqëror:

1. Shkenca shoqërore 25 $25 \times 1.2 = 30$ pikë

2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze	25	$25 \times 0.6 = 15$ pikë
3. Matematikë dhe Informatikë	25	$25 \times 0.4 = 10$ pikë
4. Shkenca natyrore	25	$25 \times 0.2 = 5$ pikë
		Totali = 60 pikë

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është minimumi 40% ose 10 pikë.

P.sh. Pikët (Fizikë + Biologji + Kimi) = min.10 pikë

Pikët (Matematikë + T. informative) = min. 10 pikë

5. Renditja e lëndëve me prioritete sipas profileve në shkolla profesionale

I. Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari

1. Shkencat natyrore	25	$25 \times 1.2 = 30$ pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze	25	$25 \times 0.6 = 15$ pikë
3. Matematikë dhe Informatikë	25	$25 \times 0.4 = 10$ pikë
4. Shkencat shoqërore	25	$25 \times 0.2 = 5$ pikë

Totali = 60 pikë

II. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi – Teknologji

1. Matematikë dhe Informatikë	25	$25 \times 1.2 = 30$ pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze	25	$25 \times 0.6 = 15$ pikë
3. Shkenca natyrore	25	$25 \times 0.4 = 10$ pikë
4. Shkenca shoqërore	25	$25 \times 0.2 = 5$ pikë

Totali = 60 pikë

III. Ekonomi

1. Matematikë dhe informatikë	25	$25 \times 1.2 = 30$ pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze	25	$25 \times 0.6 = 15$ pikë
3. Shkenca shoqërore	25	$25 \times 0.4 = 10$ pikë
4. Shkencat natyrore	25	$25 \times 0.2 = 5$ pikë

Totali = 60 pikë

IV. Juridik

1. Shkencat shoqërore	25	$25 \times 1.2 = 30$ pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze	25	$25 \times 0.6 = 15$ pikë
3. Matematikë dhe Informatikë	25	$25 \times 0.4 = 10$ pikë
4. Shkenca natyrore	25	$25 \times 0.2 = 5$ pikë

Totali = 60 pikë

V. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm

1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze	25	$25 \times 1.2 = 30$ pikë
2. Shkenca shoqërore	25	$25 \times 0.6 = 15$ pikë
3. Matematikë dhe Informatikë	25	$25 \times 0.4 = 10$ pikë
4. Shkenca natyrore	25	$25 \times 0.2 = 5$ pikë
		Totali = 60 pikë

VI. Shkollat Artistike

1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze	25	$25 \times 1.2 = 30$ pikë
2. Shkenca shoqërore	25	$25 \times 0.6 = 15$ pikë
3. Matematikë dhe Informatikë	25	$25 \times 0.4 = 10$ pikë
4. Shkenca natyrore	25	$25 \times 0.2 = 5$ pikë
		Totali = 60 pikë

VII. Kriteret specifike për regjistrimin në shkolla të muzikës

a. Drejtimi pedagogjik – profili bashkëpunëtor muzikor:

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe testin kombëtar.

b. Drejtimi instrumental:

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VII).

c. Në klasën e VII të shkollës së muzikës mund të regjistrohen vetëm nxënësit që kanë përfunduar shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VI).

e. Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë – duhet t'i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

Kriteret për Gjimnazin e shkencave shoqërore dhe gjuhësore (Për shkollat Pilot)

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë **100** pikë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 25 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\frac{\text{Suksesi}(kl.6 + kl.7 + kl.8 + kl.9)}{4} \times 5 = 25$$

2. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 15 pikë
Për këtë gjimnaz merren 5 lëndë me prioritet: gjuhë amtare, gjuhë angleze, histori, gjeografi dhe edukatë qytetare.

$$\frac{mes.gj.amtare + mes.gj.ang. + mes.his + mes.gjeo. + mes.ed.qytet.}{5} \times 3 = 15 \text{ pikë}$$

4. Renditja e lëndëve me prioritet sipas drejtimeve të gjimnazeve:

Gjimnazi shoqëroro-gjuhësor:

- | | | |
|--|----|-----------------------------------|
| 1. Gjuhë amtare, gjuhë angleze dhe shkenca shoqërore | 50 | $50 \times 0.9 = 45 \text{ pikë}$ |
| 2. Matematikë dhe Informatikë | 25 | $25 \times 0.4 = 10 \text{ pikë}$ |
| 3. Shkenca natyrore | 25 | $25 \times 0.2 = 5 \text{ pikë}$ |

Totali = 60 pikë

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është minimumi 40% ose 10 pikë. (në rastin e këtij drejtimi 20 pikë)

$$50 \times 0.9 = 45 \text{ pikë}$$

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE TË RREGULLT NË GJIMNAZIN E SPECIALIZUAR MATEMATIK

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në gjimnazin e specializuar matematikor, për vitin shkollor 2016/17, mund të konkurrojnë **vetëm nxënësit e shkëlqyeshëm**, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Kandidatët kanë të drejtë të jenë nga të gjitha komunat e Kosovës, të cilët konsiderojnë se kanë prirje për Matematikë.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

1. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në këtë gjimnaz, duhet të paraqesin këto dokumente (Mund të dorëzohen në origjinal por mjafton edhe në kopje):

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollë)
- Dëftesën e fotokopjuar për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes.

2. Kriteret për regjistrim

Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë – duhet t'i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

- Kandidatët kanë të drejtë të jenë nga të gjitha komunat e Kosovës, të cilët konsiderojnë se kanë prirje për Matematikë.
- Kandidatë do t'i nënshtrohen Provimit Pranues.
- Provimi pranues përgatitet, kontrollohet nga mësimdhënës të Autorizuar nga Bordi.
- Kandidatët mund të mos i tërheqin dokumentet nga shkollat ku janë pranuar. Mjafton të sjellin dëshmitë e fotokopjuara.
- Për rangimin final të kandidatëve merren parasysh:
 - Suksesi i Përgjithshëm nga Shkolla e mesme e ulët (20%);
 - Suksesi nga Lënda e Matematikës në Shkollën e mesme të ulët (20%);
 - Suksesi nga Testi i Arritshmërisë nga lënda e matematikës (20%);
 - Suksesi i Provimit Pranues (40%).

3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnazin e specializuar, për vitin shkollor 2016/2017, bëhet prej datës **14, 15 dhe 16 qershor 2016** në lokalet e shkollës amë, duke filluar nga ora 9.00-16.00.

Provimi pranues me datën **17 qershor 2016**

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollën përkatëse me datën **20 qershor 2016**.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej **21 qershor 2016**.

AFATI I ANKESAVE

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, **brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës.**

Vërejtje: Mosparaqitja e ankesës në afatin zyrtar, në shkollën përkatëse, nënkupton humbje e të drejtës për ankesë në shkollën e dytë në Drejtorinë e Arsimit (DKA) apo në Ministrinë e arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). DKA dhe MASHT nuk shqyrton asnjë ankesë nëse ajo paraprakisht nuk është shqyrtuar nga komisioni përkatës i shkollës.